

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6416  
E premte, 17 shtator 2021  
çmimi 0.40 €

## Bie numri i të shtrirëve në spitale me Covid



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FILLON FUSHATA ELEKTORALE PËR ZGJEDHJET LOKALE NË KOSOVË

# PARTITË PËRQENDROHEN NË FUSHATË DIGJITALE

Zyrtarisht fushata për zgjedhjet lokale të 17 tetorit ka filluar të enjten në Kosovë. Partitë politike nuk kanë bërë ndonjë hapje ceremoniale për shkak të situatës me pandeminë Covid-19. Përfaqësuesit e subjekteve politike kanë bërë me dije se do t'i shmangen fushatës tradicionale me tubime të mëdha të qytetarëve. Ata janë zotuar se në aktivitetet e tyre elektorale do të fokusohen në fushatë digjitale dhe do t'i respektojnë rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. LDK-ja dhe AAK-ja janë deklaruar për shkurtrimin e fushatës në pesë ditë, kurse LV-ja dhe PDK-ja, ndonëse janë shprehur pro shkurtrimit të fushatës, nuk kanë dhënë ndonjë qëndrim zyrtar



## AKTUALE



**RAMA: RESPEKTOJMË VENDIMET E KOSOVËS, POR SHQIPËRISË S'MUND T'I JEPEN LEKSIONE**

**LARGOHET GRUPI I PARË I AFGANËVE NGA KOSOVA**

**KOMUNA E MALISHEVËS EKZEKUTON PAGESËN PËR 216 STUDENTË PËRFITUES TË BURSIVE STUDENTORE**



## KURTI DHE ZAEVI, QËNDRIME TË NDRYSHME PËR NISMËN 'BALLKANI I HAPUR'




**LAJÇAKU BESON SE OPOZITA DO TË JETË KONSTRUKTIVE PËR DIALOGUN**



## EKONOMI

**ZGJATET AFATI I APLIKIMIT PËR KUZHINA POPULLORE NË KUADËR TË MASËS 3.4**

**KOSOVA DHE SHQIPËRIA DO TA AVANCOJNË EDHE MË TUTJE BASHKËPUNIMIN EKONOMIK**



## SPORT



**PRISHTINA ENDE PA FITORE NË SUPERLIGË, DRENICA KRYESON**

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Rama: Respektojmë vendimet e Kosovës, por Shqipërisë s'mund t'i jepen leksione

TIRANË, 16 SHTATOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka paraqitur të enjten në Kuvend programin e qeverisë së tij, me të cilin do ta udhëheqë mandatin e tretë të fituar më 25 prill. Në adresimin e tij para deputetëve, Rama ka folur edhe për Kosovën dhe projektin "Ballkani i hapur". Ai ka thënë se me Qeverinë e Kosovës dëshiron të bashkëpunojë. "Për Kosovën ne mund të flasim dhe u takon autoriteteve atje që marrin vendim, ndërsa ne na takon t'i respektojmë. Ama e njëjta gjë vjen dhe anasjelltas, nëse nuk na pëlqejnë vendimet e njëri-tjetrit, bujrim, t'i diskutojmë, por

kursesi t'i shpallim si tradhtarë ata që mendojnë ndryshe, duke luajtur me dhimbjet e njerëzve të përvëlur nga lufta, por edhe me padijen e atyre që pushkët i nxjerrin vetëm në ekran dhe në "Facebook", ka thënë Rama. Ai ka deklaruar se as Kosova nuk mund t'i japë leksione Shqipërisë për vendimet që merr. "Unë dua që me Qeverinë e Kosovës të bashkëpunojmë. Shqipërisë nuk mund t'i jepen leksione. Vendimet sovraane të Shqipërisë nuk mund të diskutohen asgjëkund. Koha do të tregojë më shpejt se kush ka të drejtë", ka theksuar Rama në fjalën e tij.



## Franca pezullon mijëra punonjës shëndetësorë të pavaksinuar



PARIS, SHTATOR - Rreth 3 000 punonjës shëndetësorë në Francë u pezulluan nga puna pasi nuk ishin të vaksinuar kundër koronavirusit. Rregulli i ri, i cili hyri në fuqi të mërkurën, e bën vaksinimin të detyrueshëm për të 2.7 milionë punëtorët e kujdesit shëndetësor, të shtëpive të pleqve dhe të shërbimit të zjarrfikësve. Ministri i Shëndetësisë i Francës, Olivier Veran, ka thënë

të enjten se shumica e pezullimeve janë vetëm të përkohshme. "Shumë prej tyre tani janë dakord të vaksinohen, sepse 'e shohin se vaksinimi i detyrueshëm është realitet'", ka thënë ai, duke shtuar se rregulli vlen për të gjithë mjekët, infermierët, stafin e zyrave dhe vullnetarët. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, i ka paralajmëruar punonjësit për ndryshim të rregullit qysh më 12 korrik, duke

u thënë se duhet të marrin së paku një dozë të vaksinës deri më 15 shtator ose të japin dorëheqje nga puna e tyre. Muajin e kaluar disa punonjës të kujdesit shëndetësor dhe zjarrfikës në Francë kanë protestuar kundër këtij rregulli. Franca ka konfirmuar mbi 113 000 viktima nga koronavirusi. Autoritetet thonë se shumica e të shtruarve në spital javën e fundit janë pacientë të pavaksinuar.

## Kritika ndaj BE-së për mbështetje të paktë ndaj afganëve

BRUKSEL, 16 SHTATOR - Grupet e të drejtave të njeriut dhe të refugjatëve po i bëjnë thirrje Bashkimit Evropian (BE) të tregojë gatishmëri më të madhe për të mbrojtur afganët që po përpiqen të largohen nga vendi i tyre pasi ndihen të rrezikuar nga talebanët të cilët e morën vendin nën kontroll muajin e kaluar. "Në vend se të shmangët, BE-ja duhet të ndajë përgjegjësinë për t'u ofruar mbrojtje atyre", thanë Amnesty International, Caritas Europa dhe 22 organizata të tjera në një

deklaratë të përbashkët më 16 shtator. Ato u bënë thirrje 27 shteteve anëtare të BE-së që "t'i zgjerojnë mundësitë për njerëzit që kanë nevojë për mbrojtje, përfshirë përmes një programi ambicioz dhe shtesë të zhvendosjes për refugjatët afganë". Ende nuk ka pasur një reagim nga BE-ja. Agjencia e Azilit e BE-së (EASO) raportoi më 16 shtator se kërkesat për azil nga ana e afganëve u rritën për të pestin muaj radhazi.



Dhjetëra mijëra afganë u larguan nga vendi pasi talebanët rrëzuan qeverinë e mbështetur nga Perëndimi në Kabul një muaj më parë. Mijëra njerëz të tjerë duan të largohen nga vendi i shkatërruar nga lufta, varfëria dhe thatësira.

Vendet evropiane kanë frikë se mund të përsëritet skenari i vitit 2015 kur 1 milion njerëz ikën nga luftërat dhe varfëria në Lindje të Mesme dhe ua mësyn vendeve evropiane. Disa vende evropiane po mbajnë qëndrim të përbashkët për mospranimin e më shumë refugjatëve afganë në Bashkimin Evropian. BE-ja ka pranuar mijëra refugjatë afganë përmes një evakuimi të organizuar dhe të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara. Të evakuuarit kanë qenë kryesisht personat që kanë

punuar me forcat e huaja në këtë vend dhe familjet e tyre. "Na vjen keq për retorikën mashtruese dhe alarmante të shprehur nga disa udhëheqës evropianë në javët e fundit", thanë grupet e të drejtave të njeriut në deklaratën e tyre. Sipas deklaratës, Irani dhe Pakistani aktualisht strehojnë gati 90 për qind të afganëve të zhvendosur. Në këto dy vende janë mbi dy milionë refugjatë të regjistruar. Organizatat thonë se këtë përgjegjësi nuk duhet ta mbajnë vetëm këto dy vende.

## Dhjetëra bashkëpunëtorë të Putinit u diagnostikuan me koronavirus

MOSKË, 16 SHTATOR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka bërë me dije se do të mbetet në vetizolim edhe për disa ditë, pasi "dhjetëra anëtarë të rrethit të tij të

brendshëm" dolën pozitivë me koronavirus. Putin ka folur përmes videolidhjes në një konferencë të Organizatës së Traktatit të Sigurisë Kolektive që u mbajt

në Dushanbe. "Për fat të keq, më është dashur ta anuloj udhëtimin tim në Dushanbe në momentin e fundit. Më vjen keq për këtë. Por, siç e dini, koronavirusi është

zbuluar jo vetëm në një ose dy persona, por në disa dhjetëra njerëz të rrethit tim. Kështu që tani më duhet të qëndroj në izolim për disa ditë", ka deklaruar Putin.



KOSOVA DHE MAQEDONIA E VERIUT KANË MBAJTUR MBLEDHJEN E PËRBASHKËT TË DY QEVERIVE NË SHKUP

# Kurti dhe Zaevi, qëndrime të ndryshme për nismën 'Ballkani i hapur'



Mbledhja e parë e përbashkët e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës, e cila është mbajtur të enjten në qytetin e Shkupit, është vlerësuar e rëndësishme së veçantë nga kryeministri Albin Kurti dhe nga Zoran Zaev. Kjo mbledhje qeveritare, sipas tyre, është edhe një konfirmim për marrëdhëniet e shkëlqyera miqësore që kanë këto dy vende. Por Kurti dhe Zaevi kanë shfaqur qëndrime të ndryshme sa i përket nismës 'Ballkani i hapur'

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**SHKUP, 16 SHTATOR** - Maqedonia e Veriut dhe Kosova synojnë integrimin evropian, por kryeministri Albin Kurti dhe Zoran Zaev, pas mbledhjes së përbashkët të qeverive që u mbajt të enjten në Shkup, përsëritën qëndrimet e tyre të ndryshme lidhur me nismën 'Ballkani i hapur'. "Ne dëshirojmë sa më shumë bashkëpunim, marrëveshje dhe zbatim të tyre në aspektin bilateral dhe dëshmi për këtë është mbledhja e dy qeverive. Jemi të orientuar kah e ardhmja, e për ne e ardhmja është Bashkimi Evropian. Pra, BE-ja është fati ynë, ndërkaq Evropa është kontinenti ynë, andaj edhe si Republikë e Kosovës ne mbështetim të gjitha iniciativat rajonale në të cilat e kemi Bashkimin Evropian të cilat janë nga BE", ka deklaruar kryeministri i Kosovës, Albin Kurti.

Kryeministri maqedonas Zoran Zaev ka theksuar se nismat rajonale, përfshirë edhe

'Ballkanin e hapur', janë në interes të vendosjes së një bashkëpunimi më të mirë mes shteteve, si lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe forcimin ekonomik të shteteve, me synimin e fundit, integrimin në Bashkimin Evropian. "Për çështjen e Ballkanit të hapur si kryeministra kemi qëndrime të ndryshme, por kjo nuk paraqet asnjë pengesë që të kemi bashkëpunim të shkëlqyeshëm, pasi e kemi për obligim që t'u shërbejmë qytetarëve tanë, ekonomisë, institucioneve dhe pikërisht këtë po bëjmë. Unë mund të them se Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, ka qëndrimet e saj dhe ne i respektojmë ato", ka deklaruar kryeministri Zoran Zaev, duke theksuar nevojën që në Ballkan të ketë dialog dhe bashkëpunim mes shteteve. "Çdo marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe këtu në rajon ka për qëllim të ardhmen më të shpejtë dhe më të sigurt në Bashkimin Evropian", ka deklaruar Zaev duke i vlerësuar shumë të rëndësishme edhe nismat e tjera rajonale, në veçanti Procesin e Berlinit, për

## Kosova dhe Maqedonia e Veriut nënshkruajnë 11 marrëveshje bashkëpunimi

Në mbledhjen e dy qeverive në Shkup janë nënshkruar 11 marrëveshje bashkëpunimi në sfera të ndryshme, si ajo për studimin e fizibilitetit për rrugën Prizren - Tetovë, për lidhjen e Brezovicës me qendrën turistike Kodra e Diellit në Tetovë, lehtësimin e kalimeve kufitare, marrëveshjen për bashkëpunim hekurudhor, bashkëpunim në sektorët e energjisë, kontrollit të mallrave, inovacionit, zhvillimit teknologjik e fusha të tjera. Mbledhja e parë e përbashkët e të dy qeverive, e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e Republikës së Kosovës, ka theksuar kryeministri Zaev, është edhe një konfirmim për marrëdhëniet e shkëlqyera miqësore, për bashkëpunimin e ngushtë, për realizimin e vazhdueshëm të interesave të ndërsjella dhe për ndarjen e përcaktimeve të përbashkëta për Ballkanin Perëndimor si rajon i qëndrueshëm i paqes, plotësisht i integruar në BE dhe NATO. "Jam i bindur se nga mbledhja do të dalin më

shumë projekte që do të mundësojnë bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet qeverive dhe ministrive dhe institucioneve kompetente të cilat janë në interes të qytetarëve tanë. Ka edhe shumë mundësi para nesh. Na lidhin shumë interesa të përbashkëta, kështu edhe ekonomitë tona janë të drejtuara drejt njëra-tjetrës", ka theksuar Zaev në fjalën e tij në mbledhjen e përbashkët. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka vlerësuar mbajtjen e mbledhjes së përbashkët të dy qeverive si moment historik i marrëdhënieve në mes dy vendeve. "Një shfletim i shkurtër nëpër faqet e historisë e gjen në një vend edhe Shkupin edhe Prishtinën, edhe Prizrenin edhe Tetovën, dhe se vendet tona ndajnë shumëçka me njëra-tjetrën pasi historia jonë është e mbushur me ngjarje të cilat në mënyrë të pandashme kanë përcaktuar fatin tonë", është shprehur kryeministri Kurti. Kurti është pyetur është për

rastin "Mostra", apo nëse me kryeministrin maqedonas kanë diskutuar për ekstradimin e dy shtetasve të Maqedonisë së Veriut që ndodhen në Kosovë, e që janë dënuar për një vrasje të pesëfishtë, në Shkup, në vitin 2012.

Kurti tha se ministrat e drejtësisë të dy vendeve janë në kontakt dhe se po bashkëpunojnë për këtë çështje, por edhe për raste të tjera nga e kaluara duke aluduar në rastin e Kumanovës që, siç tha, kërkojnë edhe ndihmë ndërkombëtare për zbardhjen e së vërtetës. Kjo është mbledhja e parë e përbashkët mes qeverive të dy vendeve, e cila, siç kanë thënë nga qeveria në Shkup, "konfirmon marrëdhëniet e shkëlqyera miqësore midis Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës në drejtim të thellimit të bashkëpunimit në fushatë e interesit të ndërsjellë mes dy vendeve dhe shkëmbimit të përvojave për bashkëpunim më intensiv në rajon".

rëndësinë e të cilit, siç ka thënë, është diskutuar edhe në takimet në Tiranë me kancelaren gjermane Angela Merkel. Iniciativa 'Ballkani i hapur', i

njohur më parë si Mini-Shengeni Ballkanik, është krijuar nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vučić dhe

kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Ata besojnë se kjo iniciativë ofron mundësi për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe lëvizjes.



FILLON FUSHATA ELEKTORALE PËR ZGJEDHJET LOKALE NË KOSOVË

## Partitë përqendrohen në fushatë digjitale

Zyrtarisht fushata për zgjedhjet lokale të 17 tetorit ka filluar të enjten në Kosovë. Partitë politike nuk kanë bërë ndonjë hapje ceremoniale për shkak të situatës me pandeminë Covid-19. Përfaqësuesit e subjekteve politike kanë bërë me dije se do t'i shmangen fushatës tradicionale me tubime të mëdha të qytetarëve. Ata janë zotuar se në aktivitetet e tyre elektorale do të fokusohen në fushatë digjitale dhe do t'i respektojnë rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. LDK-ja dhe AAK-ja janë deklaruar për shkurtrimin e fushatës në pesë ditë, kurse LV-ja dhe PDK-ja, ndonëse janë shprehur pro shkurtrimin të fushatës, nuk kanë dhënë ndonjë qëndrim zyrtar

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 16 SHTATOR** - Partitë politike e kanë filluar të enjten fushatën për zgjedhjet lokale të 17 tetorit. Për shkak të situatës me pandeminë Covid-19, nuk kanë bërë hapje të zakonshme me organizime të mëdha. Hapja e fushatës është bërë me ceremoni digjitale, duke i informuar qytetarët me pikat kryesore të programeve të tyre. Përfaqësuesit e subjekteve politike janë zotuar se nuk do të mbajnë tubime të mëdha elektorale dhe do t'i respektojnë në përpikëri rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) kundër përhapjes së pandemisë Covid-19. Ata kanë bërë me dije se aktivitetin e tyre elektorale do ta orientojnë në rrjetet sociale dhe në debatet në televizione.

Zëdhënësi i Partisë Demokratike të Kosovës, Faton Abdullahu, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se gjatë kësaj fushate do të mbrojnë jetën e qytetarëve, duke përjashtuar grumbullimet e mëdha konvencionale. "Kemi analizuar gjithanshëm situatën aktuale, sidomos atë pandemike në raport me fushatën zgjedhore dhe, për rrjedhojë, si parti kemi qëndrim që në rend të parë, me angazhime shtesë, t'i respektojmë gjithanshëm dhe pandalshëm vendimet dhe rekomandimet e IKShPK-së. Kemi vendosur që parimisht të përqendrohemi në fushatë digjitale, duke përjashtuar grumbullimet e mëdha konvencionale, sepse jemi të bindur se kështu mbrojmë jetën e qytetarit dhe ndihmojmë në përmirësimin e gjendjes pandemike e cila është përkeqësuar deri në këtë shkallë alarmante për shkak të

menaxhimit joadekuat nga ana e qeverisë", ka deklaruar Abdullahu. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, përmes një video në profilin e vet në "Facebook", ka kërkuar votë nga qytetarët për AAK-në. "Shëndeti është mbi të gjitha, meqenëse nuk do të kemi mundësi të takohemi si herëve të tjera që të bashkëbisedojmë, që po ashtu të paraqesim programin tonë zgjedhor të Aleancës dhe njëkohësisht të prezantojmë kandidatët tanë dhe kandidatët për kryetar komune dhe për asamble komunale, atëherë ju drejtohem në këtë mënyrë. Ju siguroj se programi i Aleancës për qeverisjen në komuna, që bazohet në qeverisje me qytetarin, është programi i duhur për të kthyer jetën, zhvillimin ekonomik dhe normalitetin në komunat tona

dhe në Kosovë", ka shkruar ai, duke i ftuar qytetarët të votojnë për kandidatët e AAK-së më 17 tetor. "Ju siguroj se kandidatët për kryetarë nga Aleanca, kryetarët aktualë të komunave dhe kandidatët e tjerë janë njerëz me dinjitet, janë njerëz të zotë, janë profesionistë të mirë që nga Ardian Gjini në Gjakovë, Daut Haradinaj në Prishtinë, Bali Muharremaj në Suharekë, Zenun Elezaj në Klinë, Smajl Latifi në Rahovec, Bashkim Ramosaj në Deçan, Besnik Tahiri në Podujevë, Bekë Berisha në Istog, Rrustem Berisha në Pejë, Agron Kuqi në Junik, Lulëzim Kabashi në Prizren, Faton Jakupi në Kamenicë, Arta Ahmeti Xhyllani në Drenas, Nazim Gagica në Gjiçan, Agron Gashi në Dragash, Hasan Ismajli në Fushë-Kosovë, Xhelal Krasniqi në Obiliq, Arben Halili në Ferizaj, Mensut Ademi në Vushtrri, Kastriot Berisha në Malishevë dhe Bashkim Budakova në Lipjan. Të gjithë këta janë njerëz të dinjitetshëm, profesionistë dhe të aftë t'i udhëheqin komunat", ka thënë Haradinaj. Edhe përfaqësuesit e partive të tjera politike janë zotuar se në aktivitetet e tyre do t'i respektojnë masat kundër Covidit.

### Motot e partive politike

Pavarësisht situatës me pandeminë, subjektet politike i kanë bërë të gjitha përgatitjet për zgjedhjet lokale. Përveç prezantimit të kandidatëve për kryetar të komunave dhe të kandidatëve për asamble komunale, ato kanë zgjedhur tashmë edhe motot me të cilat do të garojnë në këto zgjedhje. Lëvizja Vetëvendosje, e cila në zgjedhjet e 17 tetorit në fletëvotim do ta ketë numrin 144, ka zgjedhur moto sloganin "Numri për komunën". "Bashkë për Kosovën", është moto e Partisë Demokratike të Kosovës, e cila në këto zgjedhje do të garojë me numrin 177. Motoja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, që në fletëvotim do ta ketë numrin 160, do të jetë "Për të gjithë". Ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e cila në këto zgjedhje do të garojë me numrin 121, moto do ta ketë sloganin "Aleancë me qytetarin". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ditë më parë ka certifikuar listën përfundimtare të votuesve. Më 17 tetor të drejtë vote do të kenë rreth 1 milion e 885 mijë qytetarë, ndërsa 24 mijë votues

# Lajçaku beson se opozita do të jetë konstruktive për dialogun

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Emisari special i Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka takuar të enjten liderët e partive politike në Kosovë. Ai ka mbajtur takime të veçanta me liderin e PDK-së, LDK-së dhe AAK-së. Lajçak ka thënë se partitë politike opozitare në Kosovë kanë përvojë në procesin e dialogut. Pas takimit me përfaqësuesit e

partive opozitare, ai ka thënë se beson që këto parti do të jenë konstruktive në këtë proces. "Kërkova mbështetje për dialogun, pasi arritja e një marrëveshje përfundimtare është në të mirën e Kosovës. Partitë opozitare kanë përvojë në dialog dhe për mua ishte e rëndësishme të dëgjoj mendimin e tyre. Po ashtu, besoj se do të jenë konstruktive. I konsideroj këto takime shumë të rëndësishme dhe jam i kënaqur me rezultatet", ka thënë Lajçak.

Emisari i BE-së të enjten është takuar edhe me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca. Edhe në këtë takim është biseduar për ecurinë e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, bashkëpunimin rajonal dhe perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Konjufca ka thënë se dialogu duhet të rezultojë me njohje reciproke dhe përsëriti qëndrimin se rendi kushtetues, sovraniteti, integriteti territorial dhe pavarësia e Kosovës janë të

panegociueshme. "Asnjëherë nuk do të pranojmë që këto postulate të shtetit tonë të jenë temë e bisedimeve me Serbinë", ka thënë Konjufca. Kreu i Kuvendit, po ashtu, vuri në spikamë angazhimet parlamentare lidhur me miratimin e ligjeve dhe harmonizimin e tyre me ato të BE-së, duke ritheksuar se perspektiva e Kosovës është në Bashkimin Evropian. Një ditë më parë Lajçaku ka zhvilluar një takim edhe me kryeministrin Albin Kurti. Edhe

në këtë takim mbarëvajtja e procesit të dialogut në Bruksel, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe hapat e ardhshëm në këtë proces, ishin në qendër të takimit. Kryeministri Kurti ka ritheksuar se në dialog Kosova është palë e barabartë, jo temë. "Duhet të pranohet realiteti dhe të jemi në shërbim të qytetarëve të të dy vendeve, nëpërmjet një marrëveshjeje të qëndrueshme dhe të zbatueshme, që në qendër ka njohjen reciproke", ka thënë Kurti.



do të jenë të rinj për dallim nga zgjedhjet e fundit të parakohshme. Gjithashtu, në listën zyrtare të votuesve janë përfshirë edhe 90 mijë votues që në zgjedhjet e fundit votuan jashtë vendit. Për shkak të situatës me pandeminë, disa nga partitë politike janë shprehur për shkurtimin e periudhës së fushatës, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Kryetari i Lidhjes Demokratike

të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ditë më parë u kishte dërguar një letër kryetarëve të partive parlamentare ku, për shkak të situatës me pandeminë, kishte propozuar që fushata të reduktohet në 10 ditë, ndërkaq dy ditë më parë ka deklaruar se fushata e LDK-së do të jetë vetëm pesë ditë.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, kishte thënë se shkurtimi i fushatës

zgjedhore duhet të trajtohet dhe për këtë të merret vendim. Ndërkaq kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, kishte thënë se fushata zgjedhore duhet të shkurtrohet edhe më shumë, vetëm në pesë ditë.

Edhe Lëvizja Vetëvendosje në parim është shprehur për shkurtimin e fushatës, por nuk ka dhënë ndonjë qëndrim. Fushata për zgjedhjet e 17

tetorit do të jetë 30 ditë ashtu siç parasheh Ligji për Zgjedhje. Ditë më parë IKShPK-ja i kishte rekomanduar presidentes Vjosa Osmani shtyrjen e këtyre zgjedhjeve, duke vlerësuar se grumbullimi i njerëzve do të ndikojë në shpërndarjen e koronavirusit. Mirëpo pozita dhe opozita në takim me presidenten nuk kishin arritur një konsensus për këtë çështje. Në atë takim Lëvizja

Vetëvendosje ka kërkuar që zgjedhjet e 17 tetorit të shtyhen, kurse opozita ka kundërshtuar qëndrimin e partisë më të madhe në vend. Edhe rrjeti i organizatave joqeveritare që promovon zgjedhje të lira dhe të drejta përmes monitorimit të procesit zgjedhor, Demokracia në Veprim, ka kërkuar që zgjedhjet lokale të mbahen, duke respektuar masat kundër Covidit.

## Komuna e Skenderajt hap thirrjen për aplikim për grante

SKENDERAJ, 16 SHTATOR (ER) - Pas mbajtjes së sesionit informuese, lidhur me projektin "Fuqizimi socio-ekonomik i Ballkanit

Perëndimor", projekt ky i financuar nga komuna e Skenderajt, Qeveria e Gjermanisë dhe organizata "Help Kosovo",

është bërë hapja e aplikimit për përfitimin e granteve në vlerë deri në 2 000.00 euro. Komuna e Skenderajt ka njoftuar se

aplikacionet e plotësuara dhe dokumentet mbështetëse duhet të dorëzohen brenda afatit të caktuar deri më 31 nëntor.



## Votohet buxheti i komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2022

KAÇANIK, 16 SHTATOR (ER) - Legjislatura e gjashtë e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut të enjten ka mbajtur mbledhjen e fundit të rregullt të këtij mandati katërvjeçar. Fillimisht propozim-vendimin për buxhetin e komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024 i ka paraqitur drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, Bahri Selimi, i cili ka treguar se buxheti për vitin 2022 është 9 milionë e 193 mijë euro. Ai ka thënë se projektbuxheti iu ka

nënshtruar disa dëgjimeve publike me qytetarë dhe grupeve të caktuara të interesit. Ndërkaq kryetari i komunës, Besim Ilazi, ka falënderuar delegatët e kuvendit për punën dhe bashkëpunimin gjatë këtyre katër vjetëve, duke shtuar se edhe kritikën dhe sugjerimet gjithmonë kanë qenë në të mirë të qytetarëve. Ndërsa anëtarët e kuvendit nga opozita kanë dhënë vërejtjet e tyre sa i përket propozim-buxhetit. Ata konsideruan se si projekt nuk i mbulon nevojat e qytetarëve, duke kërkuar



investime më të mëdha në ujësjellës, kanalizim e bujqësi. Me shumicë votash kuvendi i

komunës ka miratuar propozim-vendimin për buxhetin e komunës së

Kaçanikut për vitin fiskal 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024.

## Parandalohet kontrabanda në Qendrën e Paraburgimit Gjilan

GJILAN, 16 SHTATOR (ER) - Në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan oficerët korrektues kanë arritur ta parandalojnë futjen e kontrabandës brenda qendrës. "Oficerët korrektues gjatë kontrollit në portën hyrëse të qendrës kanë hetuar se avokati Y. H. në çantën e dorës kishte një telefon mobil të tipit 'Nokia' me sim kartelë, për të cilin dyshohet

se tentonte ta fuste brenda qendrës. Me të hetuar këtë veprim, i menjëhershëm ka qenë reagimi i stafit përgjegjës për siguri, i cili ka ndërmarrë veprimet e nevojshme, me ç'rast ka lokalizuar provat materiale", ka njoftuar Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Lidhur me rastin janë njoftuar policia dhe Oda e Avokatëve të

Kosovës të cilët po merren me rastin. "Shërbimi Korrektues i Kosovës mbetet i përkushtuar për luftimin e dukurive negative, ku hyjnë luftimi i kontrabandës, substancave narkotike, dhe nuk do të lejojë në asnjë mënyrë rrezikimin e institucioneve korrektuese me dukuritë dhe veprimet e tilla", bëhet me dije në njoftimin për media.



## Përrurohet Ambulanca e Mjekësisë Familjare në Dobratin të Podujevës



PODUJEVË, 16 SHTATOR (ER) - Të enjten është bërë përrurimi i Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Dobratin të Podujevës. Në ceremoninë solemne të hapjes së ambulantes së re në këtë fshat ishte i pranishëm edhe kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me drejtorin e Shëndetësisë, Driton Velu, stafin menaxherial të QKMF-së dhe banorë të kësaj zone. Bulliqi

me këtë rast ka thënë se në vazhden e investimeve në infrastrukturën shëndetësore sot kanë përruruar ambulanten e re në fshatin Dobratin, e cila do të ofrojë mundësi që qytetarët e kësaj ane t'i marrin shërbimet shëndetësore primare. "Prioritet yni mbetet përrirësimi i kushteve dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore për qytetarët e komunës sonë", ka thënë Bulliqi.

## Komuna e Malishevës ekzekuton pagesën për 216 studentë përfitues të bursave studentore

MALISHEVË, 16 SHTATOR (ER) - Komuna e Malishevës ka realizuar për vitin 2021 synimin e saj për përkrahje të studentëve përmes ndarjes së bursave studentore për 216

studentë bursistë. "Ekzekutimin e pagesës e ka realizuar komuna e Malishevës përmes Drejtorisë për Arsim dhe Edukim dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për 216

studentë përfitues të bursave studentore. Komuna e Malishevës të gjithë studentëve u dëshiron suksese në studimet e tyre dhe garanton që përkrahja për studentët e

komunës sonë nuk do të mungojë asnjëherë jo vetëm për ndarjen e bursave, por edhe për përkrahje të tjera për studimet e tyre", është bërë me dije në njoftimin për media.



# Largohet grupi i parë i afganëve nga Kosova



PRISHTINË, 16 SHTATOR - Nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" janë larguar 117 shtetas afganë të cilët ditë më parë ishin strehuar në Kosovë. Ky grup është nisur drejt Mbretërisë së Bashkuar. "Forcat britanike, që janë nën komandën e NATO-s, kanë ardhur në Kosovë dhe janë në krye të operacionit për të mbështetur strehimin dhe rivendosjen e tyre", thuhet në një deklaratë të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, duke falënderuar Kosovën për bujarinë e treguar lidhur me strehimin shtetasve afganë.

Jacob Webber, zëvendës-ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, tha se është i gëzuar që shtetasit afganë janë dërguar në shtetin e tij dhe se ky operacion u krye me sukses. "Ende janë rreth 700 ose më shumë afganë, bashkëpunëtorë të NATO-s, që janë ende në Kosovë, prandaj besoj se tashmë duhet të punojmë që të sigurohemi që ata të dërgohen në shtete të tjera për strehim afatgjatë", ka theksuar ai, duke shtuar se këta afganë kanë kaluar nëpër një situatë të rëndë. "Është një rrugë e vështirë që ata kanë kaluar. Atyre u ka mbetur edhe

një distancë e shkurtër që ta kalojnë. Ata janë nisur me avion drejt Mbretërisë së Bashkuar, por këtë gjë ne nuk do të mund ta bënim pa Kosovën", ka thënë Webber. Sipas Ferdinand Nikollës nga Ministria e Punëve të Brendshme, operacione të tilla për dërgimin e shtetasve afganë në shtetet anëtare të NATO-s do të bëhen edhe në ditët në vijim. "Përveç 117 qytetarëve afganë të cilët sapo lanë Kosovën, ne kemi në Kosovë të strehuar edhe 891 qytetarë afganë të cilët janë të strehuar dhe të mbrojtur përkohësisht në kampin Bondsteel dhe në

kampin Bechtel-Enka", ka treguar ai. Grupi i shtetasve afganë që u largua nga Kosova deri më tash ishte i strehuar në kampin Bechtel-Enka në Ferizaj. Në këtë kamp ishin të strehuar shtetas që kanë punuar me forcat e NATO-s në Afganistan. Këta shtetas afganë erdhën në Kosovë pasi nuk ishin të sigurt më në Afganistan kur vendi ra në duart e talebanëve. Në Kosovë deri të hënën në mesditë kanë arritur 971 refugjatë afganë. Në kampin Bechtel-Enka në Ferizaj ishin të vendosur rreth 810 refugjatë, kurse 161 në kampin

amerikan Bondsteel, po ashtu në Ferizaj. Më herët autoritetet e Kosovës kanë bërë me dije se do të strehojnë rreth 2 000 shtetas afganë të cilët kanë punuar me Shtetet e Bashkuara dhe me shtetet anëtare të NATO-s. Sipas ligjeve në fuqi, Kosova u ka dhënë qëndrim të përkohshëm deri në një vit. Për dallim nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, ku afganët që po gjejnë strehim atje janë të lirë të lëvizin jashtë hapësirave ku ata janë të vendosur, për afganët që strehohen në Kosovë ka masa më të rrepta të sigurisë.

## Bie numri i të shtrirëve në spitale me Covid

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Katërmbëdhjetë viktima nga Covid-19 janë konfirmuar të enjten në Kosovë, ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë. Sipas raportit të saj ditë më parë, në 24 orët e fundit janë konfirmuar edhe 368 raste të reja të të infektuarve. Bazuar në 6 882 testet e kryera, i bie që raste pozitive në përqindje të ketë 5.34 për qind. Ministria e Shëndetësisë ka raportuar të enjten edhe për 1 382 persona të shëruar nga koronavirusi. Aktualisht, raste aktive me Covid mbeten 13 473. Në Kosovë janë dhënë gjithsej mbi 1.1 milion vaksina kundër koronavirusit, ndërsa mbi 399

000 qytetarë janë vaksinuar plotësisht. Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) ka njoftuar të enjten se në spitale të Kosovës janë të shtrirë 719 pacientë me koronavirus. "Prej këtyre, 603 pacientë janë me oksigjeno-terapi dhe 47 në trajtim intensiv, në gjendje të rënduar shëndetësore", thuhet në njoftimin e SHSKUK-së. Numri i pacientëve të hospitalizuar është ulur për 67 pasi një ditë më parë ishin raportuar 779 pacientë. Në Klinikën e Gjinekologjisë janë katër paciente, në Klinikën e Pediatriisë katër pacientë, ndërsa në atë të Neonatologjisë po trajtohet një foshnje me koronavirus.

## Anulohet seanca e së enjtes për rastin e Salih Mustafës në Hagë

Hagë, 16 shtator - Të enjten ishte paraparë që në sallën e gjyqit të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë të vazhdonte gjykimi për krime lufte ndaj ish-pjesëtarit të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Salih Mustafa, mirëpo kjo seancë është anuluar. Në një përgjigje për "Betimi për Drejtësi", nga DhSK-ja kanë bërë me dije se seanca e së enjtes ishte

caktuar në rast se do të nevojitej më shumë kohë për deklaratat hyrëse. "Meqenëse deklaratat hyrëse ishin më të shkurtra sesa që pritej, gjykatësit kanë vendosur se nuk nevojitet të

mbahet edhe seanca e paraparë për të enjten", është thënë në përgjigjen e DhSK-së. Mustafa është deklaruar i pafajshëm në seancën e mbajtur më 15 shtator.



# BE-ja kushtëzon ndihmën ekonomike prej 14.2 miliardë eurosh për Kosovën dhe vendet e Ballkanit

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Deputetët e Parlamentit Evropian kanë dhënë dritën e gjelbër për paketën e re shumëvjeçare financiare prej 14.2 miliardë eurosh në kuadër të mekanizmit IPA III për shtetet e përfshira në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Këto mjete do të ndahen për Kosovën, Shqipërinë, Bosnje e Hercegovinën, Malin e Zi, Serbinë dhe Turqinë për një periudhë shtatëvjeçare, ku pritet t'u ndihmojë këtyre vendeve që t'i kryejnë reformat e kërkuara në procesin e para anëtarësimit. Kësaj radhe është rritja e rolit të Parlamentit Evropian për të suspenduar shfrytëzimin e këtyre mjeteve për ato shtete të cilat nuk do t'i respektojnë parimet e sundimit të ligjit. "Qëllimi i përgjithshëm i IPA III

është të mbështeten këto vende në miratimin dhe zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike për t'u përshtatur me vlerat e BE-së dhe gradualisht të inkuadrohen me ligjet, standardet dhe politikat e BE-së. Ky fond, gjenerata e tretë e IPA, mund të zvogëlojë apo suspendojë asistencën nëse respektimi i vlerave themelore - demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit shënon përkeqësim. Si pësojë, shfrytëzimi i fondeve nga IPA do të kushtëzohet me respektin e këtyre vlerave nga ana e shtetit përkatës", thuhet në njoftim. Parlamenti ka thënë, gjithashtu, se do të jetë në kontakt të përhershëm edhe me



Komisionin Evropian për të mbikëqyrur se si shpenzohen këto mjete. Propozimi për 14.2

miliardë euro për vendet e zgjerimit ishte dhënë para dy vjetësh, mirëpo procedura ka zgjatur deri tash brenda institucioneve të Bashkimit Evropian.

## Zgjatet afati i aplikimit për kuzhina popullore në kuadër të masës 3.4



PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar të gjitha organizatat joqeveritare dhe entitetet e tjera që ofrojnë shërbime të kuzhinave popullore, se është shtyrë afati deri më 19 shtator për përfitim nga masa 3.4 nga Pakoja e Ringjallje Ekonomike nga Covid-19. Kjo masë, apo mbështetja e kuzhinave popullore/humanitare, synon të sigurojë financim për

vazhdimësinë e punës së kuzhinave popullore të cilat mund të jenë ndikuar negativisht nga pandemia Covid-19. Ministria ka ftuar të gjitha organizatat joqeveritare dhe entitetet e interesuara që ofrojnë shërbime të kuzhinave popullore mund të aplikojnë në e-mail adresën [zs.mf@rks-gov.net](mailto:zs.mf@rks-gov.net). Vlera e mbështetjes financiare për çdo kuzhinë popullore, që aprovohet nga komisioni,

është deri 100 mijë euro, varësisht nga kapaciteti dhe intensiteti shërbyes i organizatës apo entitetit. Ky aktivitet ka për qëllim të sigurojë financim për vazhdimësinë e punës së kuzhinave popullore që mund të jenë ndikuar nga pandemia dhe të sigurojë që pjesa e konsiderueshme e mjeteve financiare nga ky financim të shpenzohen për blerjen e produkteve bujqësore vendore.

## Kosova dhe Shqipëria do të avancojnë edhe më tutje bashkëpunimin ekonomik



PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në vendin tonë, Qemal Minxhozi. Në këtë takim është diskutuar për situatën aktuale me pandeminë dhe ndikimin e saj në ekonomi. Me këtë rast guvernatori Mehmeti e ka

njoftuar ambasadorin Minxhozi për masat e ndërmarra nga BQK-ja që sektori financiar të vazhdojë të mbetet stabil dhe likuid si dhe të jetë i gatshëm për të ndihmuar në çdo kohë qytetarët dhe ekonominë. Në takim është folur edhe për bashkëpunimin e BQK-së me institucionet e Shqipërisë, për çka guvernatori Mehmeti ka

falënderuar të gjithë drejtuesit e tyre për ndihmën dhe gatishmërinë për të punuar së bashku në të mirë të dy vendeve. Nga ana tjetër, ambasadori Minxhozi ka falënderuar guvernatorin për informatat e ndara dhe ka shprehur gatishmërinë e tij që bashkëpunimi mes dy vendeve të avancohet edhe më shumë.

## Ndalohe katër persona për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar

PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka njoftuar opinionin publik se Departamenti i Krimeve të Rënda, konkretisht Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion, me aktvendim të prokurorit ka ndaluar personat me inicialet J. H., A. E., B. G., me dyshimin se kanë kryer veprat penale "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" nga neni 414 i KPRK-së dhe "Marrja e

ryshfeti", nga neni 421 i KPRK-së, si dhe personin me inicialet H. H., pasi dyshohet se ka kryer veprën penale "pranimi i ryshfetit në sektorin privat", nga neni 309 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Dy nga të lartcekurit, në cilësinë e zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme, dyshohen se kanë keqpërdorur pozitën zyrtare dhe kanë marrë ryshfet ashtu

që, pas zbatimit të masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit të lëshuara nga prokurori i rastit, janë arrestuar katër të dyshuarit nga Policia e Kosovës dhe me aktvendim të prokurorit janë ndaluar në kohëzgjatje prej 48-orësh të cilët vazhdojnë të qëndrojnë nën këtë masë. Prokurori i Shtetit lidhur me këtë rast është duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform autorizimeve ligjore.





# Vetmia e Amerikës Latine

**Nga: Gabriel Garcia MARQUEZ**  
**Përktheu: Avni SPAHIU**

LIGJËRATA E NOBELIT,  
8 DHJETOR 1982

Antonio Pigafetta, një navigator florentinas, që shoqëroi Magelanin në udhëtimin e tij të parë përreth botës, me rastin e kalimit nëpër tokat tona jugore të Amerikës, bëri një shkrim shumë të saktë që, megjithatë, i ngjan një aventurë në imagjinatë. Në të ai kishte shënuar se kishte parë derra me kërbizë në kofshë, zogj pa kthetra që lëshonin vetë mbi shpinë të qifteve të tyre dhe të tjerë që u ngjanin pelikanëve pa gjuhë, me sqepa si lugë. Ai shkroi se kishte parë një krijesë bastarde me kokën dhe veshët e një mushke dhe me trup deveje, këmbët e një dreri dhe jelen e një kali. Ai kishte përshkruar se si kishte reaguar vendësi i parë që kishte takuar në Patagonia, me të parë pasqyrën, me çrast ai vigan i pasionuar kishte humbur toruan, ishte terrorizuar nga imazhi i fytyrës së vet.


Ky libër i shkurtër dhe fasciuës, i cili që atëherë mbolli farën e romaneve tona të sotme, nuk është assesi një përshkrim tronditës i realitetit tonë në atë kohë. Kronikat e Indisë na kanë lënë shumë të tjera. El Dorado, ishulli ynë iluzor aq shumë i dëshiruar, është paraqitur në harta të shumta për shumë vite me radhë, me vende dhe forma të ndryshme për ta kënaqur fantazinë e hartografëve. Në kërkimin e tij për fontanën e rinisë së përjetshme, Alvar Nunjës Kabeza de Vaka mistik eksploroj tetë vjet veriun e Meksikës, në një ekspeditë zhgënjyese, anëtarët e së cilës hëngrën njëri-tjetrin dhe prej të cilëve vetëm pesë u kthyen, nga gjashtëqind sa kishin marrë atë udhë. Një nga misteret e shumta të pazbuluara të asaj epoke është ajo e njëmbëdhjetë mijë mushkave, secila prej tyre e ngarkuar me njëqind funta ar, që Cuzco i kishte lënë dikur për ta paguar haraçin e Atahualpas dhe që kurrë nuk kishte arritur në cak. Më vonë, në kohët koloniale, pulat shiteshin në Cartagena de Indias, të rritura në toka lymore, katëket e të cilave mbanin brenda kokrra të vogla ari. Lakmia e kërkuesve të arit na ka shoqëruar deri në ditët tona. Deri vonë në shekullin e fundit, një mision gjerman i emëruar për ta studiuar ndërtimin e një hekurudhe tejoqeanike matanë Ishmit të Panamasë konkludoi se projekti ishte i realizueshëm me një kusht: që binarët të mos bëheshin nga hekuri, që nuk ishte me bollëk në rajon, por nga ari.

Pavarësia jonë nga dominimi spanjoll nuk na shpëtoi nga çmendia. Gjenerali Antonio Lopez de Santana, tri herë diktator i Meksikës, organizoi një funeral madhështor për këmbën e tij të djathtë që e kishte e humbur në të ashtu-quajturën Luftë e Pastave. Gjenerali Gabriel Garcia Moreno

sundoi Ekuadorin për gjashtëmbëdhjetë vjet si monark absolut; kur vdiq, kufoma i rrinte ulur në fronin presidencial, e veshur në uniformë të plotë dhe me medaljet e shumta në gjoks. Gjenerali Maksimiliano Hernandez Martinez, despoti teozofik, shpikoi një lavjerrës për ta hetuar helmën në ushqimin e tij, kurse fenerët e rrugëve i kishte veshur me letër të kuqe për ta penguar epideminë e etheve të fruthit. Shtatorja e gjeneralit Francisko Moraz, e ngritur në sheshin kryesor të Tegucigalpas është, në të vërtetë, e Marshal Neit, e blerë në një depo skulpturash të dorës së dytë në Paris.

Para njëmbëdhjetë vjetësh kiliani Pablo Neruda, një nga poetët më të mëdhenj të kohës sonë, filloi këtë auditor me fjalën e tij. Që nga atëherë evropianët e vullnetit të mirë – dhe nganjëherë edhe ata me vullnet të keq – janë habitur, me forcë gjithnjë më të madhe, nga lajmet e mbinatyrshe të Amerikës Latine, asaj mbretërie të pafund të burrave të përhumur dhe të grave historike, kryeneçësia e pambarim e të cilave davaritet në legjendë. Nuk kemi pasur asnjë çast pushimi. Një president prometheas, i mbyllur në pallatin që digjej, vdiq duke luftuar kundër një ushtrie të tërë, i vetëm; dhe, dy aksidente të dyshimta ajrore, që ende s'janë sqaruar, këputën jetën e një presidenti tjetër zemërmadh dhe atë të një luftëtari për demokraci, i cili ia kishte kthyer dinjitetin popullit të vet. Kanë ndodhur pesë luftëra dhe shtatëmbëdhjetë grusht shtete; lindi një diktator diabolik, i cili po zbaton, në emër të Zotit, etnocidin e parë latino-amerikan të kohës sonë. Në ndërkohë, njëzet milionë fëmijë latino-amerikanë kanë vdekur para se të mbushin një vit – më shumë nga ç'kanë lindur në Evropë që nga viti 1970. Ata që kanë humbur pa gjurmë për shkak të represionit numërojnë gati njëqind e njëzetmijë, që është sikur askush të mos kishte idenë se nga kanë humbur të gjithë banorët e Upsalas. Shumë gra shtatzëna të arrestuara kanë lindur në burgjet argjentinasë, ndërkohë që askush nuk di për ecejaket dhe identitetin e fëmijëve të tyre, të cilët fshehurazi u adoptuan apo u çuan në jetimore me urdhër të autoriteteve ushtarake ngaqë u përpoqën të ndryshonin këtë gjendje të gjërave, rreth dyqind mijë burra dhe gra kanë vdekur në tërë kontinentin dhe mbi njëqind mijë kanë humbur jetën në tri vende të vogla fatkeqe të Amerikës Qendrore: Nikaragua, El Salvador dhe Guatemala. Po të kishte ndodhur kjo në Shtetet e Bashkuara, figura gjegjëse do të ishte një milion e gjashtëqind mijë vdekje të dhunshme për katër vjet.

Një milion njerëz kanë ikur nga Kili, një vend me traditë mikpritjeje – do të thotë, dhjetë për qind e popullsisë së tij. Uruguai, një vend i vogël prej dy milionë e gjysmë banorësh, që e konsideronte veten



vendi më i qytetëruar i kontinentit, ka humbur në mërgim çdo të pestin qytetar. Që nga viti 1979 lufta civile në El Salvador ka prodhuar nga një refugjat në çdo njëzet minuta. Vendi që do të mund të krijohej nga të gjithë refugjatët dhe emigrantët e detyruar të Amerikës Latine do të kishte një popullsi më të madhe se Norvegjia.

Marr guximin të them se është ky realitet përtej masash dhe jo vetëm shprehja e tij letrare ka merituar vëmendjen e Akademisë Suedeze të Letrave. Një realitet jo nga letra, por një realitet që jeton brenda nesh dhe që përcakton çdo çast të vdekjeve tona të panumërta ditore, mes të cilave ky kolumbian bredhacak dhe nostalgjik përbën vetëm një shifër, të veçuar vetëm nga rasti. Poetët dhe lypësit, muzikantët dhe profetët, luftëtarët dhe horrat, të gjitha krijesat e atij realiteti të shfrenuar, nuk është dashur të kenë shumë imagjinatë, ngaqë problemi ynë kyç ka qenë mungesa e mjeteve konvencionale për t'i bërë jetët tona të besueshme. Ky, miqtë e mi, është thelbi i vetmisë sonë.

Dhe nëse këto vështirësi, thelbin e të cilave e ndajmë, na pengojnë, është e kuptueshme që talentet racionale në këtë anë të botës, të ekzaltuara në kontemplimin e kulturave të veta, do të ishin gjetur pa mjete valide për të na interpretuar. Është më se e natyrshme që ata këmbëngulin të na matin me kutin që përdorin për vete, duke harruar se shkatërrimet e jetës nuk janë të njëjta për të gjithë dhe se kërkimi i identitetit tonë është po aq i rëndë dhe i përgjakshëm siç ka qenë edhe për ta. Interpretimi i realitetit tonë përmes mostrave që nuk janë tonat, shërben vetëm sa për të na bërë edhe më të panjohur, edhe më pak të lirë, edhe më shumë të vetmuar. Evropa e nderuar mbase do të mund të ishte më perceptivë po të përpiquej të na shihte ne në të kaluarën e vet. Sikur të kujtonte se Londrës iu deshën treqind vjet për ta ndërtuar murin e parë të qytetit dhe treqind vjet të tjera për të pasur një peshkop; se Roma jetoi në një errësirë pasigurie për njëzet vjet, derisa një mbret etrusk e futi atë në

histori dhe se Zvicra e sotme paqësore, që na gostit me djathërat e butë dhe me orët e këndshme, përgjaku Evropën me mercenarë deri në shekullin gjashtëmbëdhjetë. Madje edhe në kulmin e Renesancës, dymbëdhjetë mijë mercenarë të paguar nga ushtritë perando-rake plaçkitën dhe shkrëtëruan Romën, kurse tetë mijë banorë të saj i prenë me shpatë.

Nuk dua që t'i mishëroj iluzionet e Tonio Krogerit, ëndrrat e të cilit, për bashkimin e veriut të virgjër me jugun e pasionuar, gjetën ekzaltim këtu, para pesëdhjetë e tre vjetësh, nga Tomas Man. Por, besoj se ata evropianë mendjekthjellët, të cilët luftojnë, edhe këtu, për një atdhe më të drejtë dhe më human, do të na ndihmonin shumë më shumë sikur ta rishqyrtonin mënyrën se si na shohin ne. Solidariteti me ëndrrat tona nuk do të na bëjë të ndihemi më pak të vetmuar përderisa ai nuk përkthehet në akte konkrete të mbështetjes legjitime për të gjithë popujt që kanë iluzionin se kanë një jetë të tyre për distribuimin e botës.

Amerika Latine as nuk dëshiron dhe as që ka ndonjë arsye të jetë pion pa pasur një vullnet të vetin dhe as që është shprehje dëshire që kërkimi i saj për pavarësi dhe origjinalitet të bëhet aspiratë perëndimore. Megjithëkëtë, përparimet e navigimit që kanë ngushtuar largësi të tilla midis Amerikave dhe Evropës duken, nga ana tjetër, sikur kanë vënë në pah largësinë tonë kulturore. Përse, vallë, ai origjinalitet që na është njohur me aq gatishmëri në letërsi, po na mohohet me aq mosbesim në përpjekjet tona të rënda për ndryshim shoqëror? Pse të mendohet se drejtësia shoqërore që kërkohet evropianët progresivë për vendet e tyre, nuk mund të jetë edhe synim i Amerikës Latine, me metoda të ndryshme për kushte jo të ngjashme? Jo: dhuna dhe dhembja e pamasë e historisë sonë janë rezultat i pabarazive shekullore dhe pikëllimit të papërshkruar dhe jo një komplot i përgatitur tre mijë ligo larg shtëpisë sonë. Por, shumë liderë dhe mendimtarë evropianë kanë

menduar kësaj, me mendje çilimiu të pleqve, të cilët kanë harruar teprimet e tyre rinore, sikur të mos jenë në gjendje të gjejnë ndonjë fat tjetër pos atij të jetës nën mëshirën e dy zotëve të mëdhenj të botës. Ky, miqtë e mi, është masa e vërtetë e vetmisë sonë.

Përkundër kësaj, ndaj shtypjes, grabitjes dhe braktisjes, ne përgjigemi me jetën. As përmbytet as murtajat, as uria dhe as kataklizmet, madje as luftërat e pambarim shekull pas shekulli, nuk kanë qenë në gjendje ta mposhtin avantazhin këmbëngulës të jetës mbi vdekjen. Një avantazh ky që rritet dhe përshpejtohet: për çdo vit ndodhin shtatëdhjetë e katër milionë më shumë lindje sesa vdekje, një numër i mjaftueshëm i jetëve të reja për ta shtuar, çdo vit, popullsinë e Nju-Jorkut për shtatë herë. Shumica e këtyre lindjeve ndodhin në vendet me më pak resurse – përfshirë, natyrisht, ato të Amerikës Latine. Nga ana tjetër, vendet më prosperuese kanë arritur të akumulojnë forcë shkatërrimi sa për të zhdukur, për njëqind herë me radhë, jo vetëm qeniet njerëzore që kanë ekzistuar deri më sot, por edhe të gjitha qeniet e gjalla që kanë frymuar ndonjëherë në këtë planet fatkeq.

Në një ditë si kjo, mësuesi im, Uilliam Fokner, ka thënë: "Unë refuzoj ta pranoj fundin e njeriut". Nuk do të meritoja të qëndroja në këtë fron, që ishte i tij, sikur të mos isha plotësisht i vetëdijshëm se tragjedia kolosale që ai refuzoi ta njihnte para tridhjetë e dy vjetësh, është tani, për herë të parë që nga fillimi i njerëzimit, asgjë më shumë se një mundësi e thjeshtë shkencore. Të ballafaquar me këtë realitet të tmerrshëm, që mund të jetë dukur vetëm si një utopi giatë tërë kohës njerëzore, ne, shpikësit e tregimeve, që do të besojmë në çdo gjë, kemi të drejtë të besojmë se ende nuk është vonë që të vendosim për të tjerët se si do të vdesin, aty ku dashuria do të dëshmohej e vërtetë dhe lumturia e mundur, dhe ku racat e gjykuara në njëqind vjet vetmi do të kenë, përfundimisht dhe përjetësisht, një shans të dytë mbi tokë. /Revista "Akademia"/Telegrafi/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Prishtina ende pa fitore në Superligë, Drenica kryeson

Kampionia në fuqi e elitës, Prishtina, edhe pas javës së katërt mbetet pa fitore, pasi të enjten mbeti baras me Gjilanin (1-1). Ndërsa Drenica e mori kryesimin në Superligë falë fitores në minuat shtesë ndaj Ulpianës (0-1)



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 16 SHTATOR** - Dy ndeshjet e fundit të xhiros së katërt në BKT Superligën e Kosovës në futboll janë zhvilluar të enjten. Prishtina ka luajtur me Gjilanin dhe ka mbetur baras (1-1), kurse Drenica ka shënuar fitore ndaj Ulpianës (0-1). FC Prishtina ende është pa fitore në Superligë, pasi një gjë të tillë ia mohoi Gjilani që shënoi golin e barazimit në minutat shtesë. Në pjesën e parë nuk patë shumë raste shënimi dhe rezultati mbeti 0-0, kurse në pjesën e dytë të dyja skuadrat kërkuar golin, të cilin e para e arriti skuadra vendase gjashtë minuta pa përfunduar koha e rregullt. Gjyqtari kryesor Dardan Çaka, pas konsultimit me VAR-in, akordoi penallti, derisa nga pika e bardhë i saktë ishte Besnik Krasniqi për rezultatin 1-0. Mysafirët në shtatë minuat e fundit të ndeshjes luajtën pa një lojtar, pasi

Armend Halili u ndëshkua me karton të kuq. Në minuat shtesë mesfushori Albert Dabiqaj e bën "heroin" për mysafirët duke e barazuar rezultatin në 1-1. Pas kësaj ndeshjeje, Prishtina ka grumbulluar vetëm dy pikë, kurse gjithsejtë ka grumbulluar gjashtë pikë. Në ndeshjen tjetër skuadra e Drenicës ka fituar ndaj Ulpianës në minutën e katërt të lojës shtesë dhe me tri pikët e reja ka marrë kryesimin në BKT Superligë. Pjesa e parë e ndeshjes që u zhvillua në Suharekë përfundoi me rezultat 0-0. Në pjesën e dytë me kërkuese ishte skuadra kuqezi, kurse golin e fitores e shënoi në minutën e katërt shtesë me anë të Kreshnik Ukës. Pas këtyre tri pikëve, kuqezinjtë nga Skenderaj renditen në pozitën e parë me 10 pikë, kurse Ulpiana është e fundit me vetëm një pikë. Në javën e katërt fitores i është gëzuar edhe Malisheva që e mposhti të mërkurën Llapin (0-3), kurse Drita ndau pikët në derbin ndaj Ballkanit (0-0). Fitore të

rëndësishme arriti edhe skuadra e Feronikelit në përballje me Dukagjinin e Klinës (1-0).

## SUPERLIGA - Java 4

Prishtina - Gjilani	1-1
Ulpiana - Drenica	0-1
Drita - Ballkani	0-0
Llapi - Malisheva	0-3
Feronikeli - Dukagjini	1-0

<b>Tabela</b>	
1. Drenica	10 pikë
2. Ballkani	8
3. Drita	8
4. Malisheva	7
5. Feronikeli	6
6. Gjilani	5
7. Dukagjini	2
8. Llapi	2
9. Prishtina	2
10. Ulpiana	1
Në xhiron e pestë takohen: Gjilani-Ulpiana, Malisheva-Feronikeli, Dukagjini-Prishtina, Drenica-Drita, Ballkani-Llapi.	

## SHKURT

### Ballkani përforcohet me Solomonin

Lideri i Superligës së Kosovës në futboll, Ballkani, është përforcuar me një futbollist cilësor. Fjala është për sulmuesin Theophilus Solomon i cili ka bërë karrierë në disa klube kroate dhe me Partizanin e Shqipërisë. "Theophilus Solomon sot është bashkuar me ekipin dhe ka mbajtur seancën e parë stërvitore me skuadrën tonë. Sulmuesit shtatlartë i urojmë mirëseardhje dhe suksese me fanellën e klubit tonë", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Suhareka.

### Trepça në Superligën e Femrave

Klubi i Basketbollit Trepça në edicionin e ri do të garojë në Superligën e Femrave. Skuadra mitrovicase ka aplikuar pas Konkursit për Wild Card nga Federata e Basketbollit e Kosovës për plotësimin e vendit të gjashtë për Superligën e Femrave, pas tërheqjes nga KB Vushtrria. Bordi i Federatës i Basketbollit të Kosovës ka vendosur që Trepça të garojë në Superligën e Femrave pas plotësimit të kërkesave të shpallura në konkurs. Trepça edicionin e kaluar ishte renditur e gjashta në Superligën e Femrave, duke rënë në një kategori më poshtë, megjithatë, pas tërheqjes së Vushtrrisë, do të garojë në elitën e femrave. Superliga e Femrave do të fillojë më 9/10 tetor 2021.

### Owen: PSG-ja, më e dobët me treshen Messi-Mbappe-Neymar

Debutimi zhgënjesës i treshes së mrekullive Messi-Neymar-Mbappe është pasuar nga shumë polemika dhe kritika. Ish-fituesi i "Topit të Artë", Michael Owen, ka qenë i drejtpërdrejtë. "Messi, Neymar dhe Mbappe janë fenomen, por unë them se PSG-ja është më e dobët me këta të tre", ka thënë ish-sulmuesi për BT Sport. "Nuk e kuptoj pse të gjithë thonë se PSG-ja është favorite për Ligën e Kampionëve. Unë besoj se skuadrat angleze (Chelsea, Liverpool, Manchester City dhe Manchester United) janë shumë më lart. Lojtarët që do të mund të bëjnë diferencën për PSG-në në Ligën e Kampionëve janë Donnarumma me Sergio Ramosin dhe jo Messi", ka shtuar Owen.

## 'Dardanët' shënojnë ngritjen më të madhe në renditjen e FIFA-s

**PRISHTINË, 16 SHTATOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka shënuar ngritjen më të lartë në ranglistën botërore të ekipeve kombëtare të FIFA-s pas publikimit të renditjes më të re nga shtëpia e futbollit botëror

të enjten. "Dardanët" janë ngritur në pozitën e 109 në renditjen e FIFA-s. Kjo ngritje ka ardhur pas fitores ndaj Gjeorgjisë dhe barazimit ndaj Greqisë në kualifikueset e Botërorit. Ndërsa edhe

kombëtarja e Shqipërisë është ngritur për tri pozita dhe tash është në vendin e 66. Kuqezinjtë e mposhtën Hungarinë dhe San Marinon. Belgjika është e para në renditjen e FIFA-s, në vend të dytë është Brazili, kurse pozitën

e tretë e ka rrembyer Anglia. Franca ka rënë në vendin e katërt dhe në vendin e pestë është kampionia e Evropës, Italia. Në top dhjetëshe janë Argentina, Portugalia, Spanja, Meksika dhe Danimarka.



## Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

**MANCHESTER, 16 SHTATOR** - Kanë përfunduar të gjitha ndeshjet e javës së parë të fazës së grupeve në Ligën e Kampionëve. Të enjten është publikuar formacioni më i mirë në të cilin nuk mungojnë befasishtë dhe emrat e mëdhenj. Porta i besohet Maignan i cili bëri paraqitje mjaft të mirë ndaj

Liverpoolit, por pësoi tre gola. Një tjetër që mund të ishte në vend të tij është Courtois, i cili mbajti portën e Realit të paprekur pavarësisht prej goditjeve të shumta nga sulmuesit e Interit. Në sulm pa dyshim që do të ishte sulmuesi i Ajaxit që shënoi "poker" golash, Haller, krah Lewandowskit

që shënoi "dopietë" dhe plotësohet me sulmuesin tjetër të Ajaxit, Antony, i cili dhuroi dy asistime pikërisht për Haller. Formacioni i javës: Maignan; Sandro, Cristiano, Otamendi, Cancelo; Henderson, Bellingham, Nkunku; Antony, Lewandowski, Haller.



## Buffon: Ende ndihem i fortë

**PARMA, 16 SHTATOR** - Gigi Buffon, portieri aktual i Parmës, foli për veten në një intervistë të gjatë me "BeInSports". Portieri gjithashtu trajtoi çështjen e së ardhmes së tij në botën e futbollit, pas atij që mund të jetë sezoni i fundit si lojtar: "Të jesh trajner është diçka që do ta doja, më shumë sesa të bëja menaxherin". Në lidhje me të tashmen e tij, megjithatë, Buffon theksoi se ishte ende shumë i motivuar: "Unë luaj sepse ndihem shumë mirë. Ende jam një portier i fortë dhe shumë i dobishëm për shokët e mi të skuadrës. Kjo është arsyeja pse zgjedha për t'u kthyer te Parma, të sillja eksperiencë, vlera dhe emocione. E di që mund të jap më të mirën. Parma ishte zgjidhja më e mirë për të vazhduar të performoj në një nivel të lartë". Dhe të mendosh se tri vite më parë ai rrezikoi të thoshte lamtumirë: "Një ditë, tri vite më parë, në fund të marsit, në Torino më pyesin: a ke vendosur të heqësh dorë? Unë them po, është e drejtë. Për shaka shtoj: nëse më duan PSG, Real



Madrid ose Barcelona, ndoshta i marr parasysh. Dhe pas 20 ditësh më kërkoi PSG-ja dhe i thashë po. Isha i magjepsur nga një ekip me aq shumë potencial në Ligën e Kampionëve dhe ky ishte një stimul i rëndësishëm, plus që mund të kisha një përvojë jashtë Italisë dhe mund të vazhdoja të luaja në nivele shumë të larta". Tema e atij momenti në Real Madrid-Juventus në "Bernabeu"

trajtohet gjithashtu prej tij. "E mbaj mend shumë mirë atë mbrëmje. Ishte momenti kur isha më krenar si kapiten i ekipit tim. Ai grup lojtarësh ishte i fortë, me guxim dhe shpirt luftarak, për pak bëri përmbysjen e madhe. Kur shkuam në Madrid kishim forcën për ta përmbysur disavantazhin e ndeshjes së parë. Ndjenjë më të mirë nuk kisha përjetuar më parë", ka shtuar Buffon.

## Kloppi: Ishim thuajse të përkryer, por për pak desh humbëm

**LIVERPOOL, 16 SHTATOR** - Liverpoolit iu desh të dërsitej deri në minutën e pestë shtesë për të siguruar suksesin kundër Milanit. Megjithatë kaluan të parët në avantazh, anglezët shpërdoruan gjithçka në 110 sekonda kur Milani përmbysi rezultatin. Fitorja erdhi, siç edhe pritej, ndaj edhe trajneri Jurgen Klopp vendos t'ua njohë meritat italianëve. "Ishte një ndeshje thuajse e përsosur, përveç faktit se për pak desh humbëm. Repartet tona humbën lidhjet dhe pësuam dy gola. Fatmirësisht, patëm rastin që të rimerrim në dorë ndeshjen duke shënuar edhe ne dy gola shumë të bukur", ka thënë Klopp. "Nuk isha e nuk jam i mërzitur. Me thënë të drejtën e prisja që mund të ndodhte kështu, sidomos duke marrë për bazë ato që ndodhën në dhjetë minutat pararendëse të golave të Milanit. U mundova t'ua



përçoja mesazhet e mia djemve në fushë, por e pata të vështirë sepse tifozët në tribunë po dhuronin spektakël. Në mesfushë duhet të jesh gjithmonë i organizuar dhe

ne nuk ishim, ndaj u ndëshkuan. Mezi prita pushimin e ndeshjes për të sistemuar disa nga problematikat tona", ka shtuar Klopp.

### SHKURT

#### Inzaghi: Courtoisi ishte i pamposhtur, jam i sigurt për kualifikim

Trajneri i Interit, Simone Inzaghi, ka folur për ndeshjen që skuadra e tij e humbi nga Real Madridi në Ligën e Kampionëve. Inzaghi ka thënë se skuadra e Interit është dashur të përqendrohet më shumë në minutat e fundit, derisa fajtor për mosshënimin e golave nga futbollistët e tij e bën portierin Courtois, i cili pati paraqitje shumë të mirë. "Duhej t'i kushtonim më shumë vëmendje, kishte mbetur akoma edhe një minutë. Na vjen keq, sepse e gjej veten duke komentuar një disfatë, pas një paraqitjeje të tillë. Por ne duhet të shikojmë përpara, të mendojmë se si luajtëm kundër një ekipi si Real Madridi. Gjetëm një portier i cili që ishte vështirë t'i shënohej. Është e qartë se kurrë nuk duhet të ulet përqendrimi ndaj tyre, por duke luajtur kështu jam i sigurt për kualifikimin", ka thënë Inzaghi.

#### PSG-ja në ankth, lëndohet Mbappe

Te Paris Saint Germaini janë shumë të shqetësuar për Kylian Mbappen. Përtej rezultatit zhgënjyes në fushën e Club Brugge, ku as tredhëmbëshi Messi-Neymar-Mbappe nuk mund ta bënte diferencën, me sfidën që u mbyll 1-1, dëmtimi i 22-vjeçarit ka shkaktuar dhimbje koke në stafin teknik dhe ankth te tifozët. Sipas Mauricio Pochettinos, Mbappe ka ndrydhur kyçin e këmbës, megjithatë një diagnozë më e saktë do të jepet shumë shpejt. Ishte hera e parë që Mbappe luante krah Neymarit e Messit njëkohësisht që nga minuta e parë, qëkur argjentinasit u transferua në "Parc des Princes".

#### Goretzka në Bayern deri në vitin 2026

Bayern Munchen nuk humbet kohë për të blinduar një nga elementët më të rëndësishëm që ka. Leon Goretzka ka firmosur një kontratë të re deri në vitin 2026. Kontrata aktuale e futbollistit të kombëtares gjermane me kampionët në fuqi të Bundesligës skadonte në përfundim të sezonit. "Me Bayernin kemi fituar gjithçka që mund të fitohej në tre vjetët e fundit. Por është edhe më bukur sesa të fitosh një titull, t'i përsëritësh këto suksese", ka deklaruar Goretzka për faqen zyrtare të Bayernit.

#### Aston Martin konfirmon Vettelin edhe për vitin 2022

Skuadra e Aston Martinit ka konfirmuar se piloti gjerman Sebastian Vettel dhe ai britanik Lance Stroll do të jenë pjesë e kësaj makine edhe në vitin e ardhshëm. Ditët e fundit ishte përfolur se Vetteli, katër herë kampion bote në Formula 1, mund të largohej, por zyrtarizimi i vërtetoi të kundërtën. "Konfirmojmë se Sebastian Vettel dhe Lance Stroll do të jenë pjesë e Aston Martinit edhe në vitin 2022. Në synojmë që vitin tjetër të kemi një rritje edhe më të madhe të paraqitjes së makinës në pistë", thuhet në komunikatën e makinës së Aston Martinit, një nga surprizat e këtij sezoni të Formulës 1.

## Salahu barazoi rekordin e Gerrardit në Ligën e Kampionëve

Mohamed Salah barazoi rekordin e Steven Gerrardit te Liverpooli për më shumë gola në Ligën e Kampionëve në "Anfield", pas golit kundër Milanit të mërkurën. Salahu shënoi në minutën e 48 të ndeshjes në Ligën e Kampionëve,

duke barazuar ndeshjen në 2-2 pasi përfundoi me sukses një asistim nga Divock Origi. Ky ishte goli i 14-t i Salah në Ligën e Kampionëve në "Anfield", duke shkuar në nivel me legendën e "Reds", Gerrard. Salahu kishte

shënuar vetëm tre gola të Ligës së Kampionëve në karrierën e tij para se të transferohej te Reds nga Roma, por që atëherë ai është bërë golashënues serik në këtë garë. Ylli egjiptian tani ka 26 gola në Ligën e Kampionëve për Liverpoolin, me më shumë se

gjysmën e atyre që vijnë në shtëpi. Një nga golat e tij më të paharrueshme erdhi nga "Anfield", pasi ai shënoi golin hapës në finalen e Ligës së Kampionëve të vitit 2019 kundër Tottenhamit me një penallti në minutën e dytë.



## K O N K U R S

- Shpallet konkurs publik për kohë të caktuar për vendin e punës në ndërmarrje si në vijim:
- **Pozita e punës:** Zyrtar/e i/e Burimeve Njerëzore
- **Numri i pozitave:** 2 (dy)
- **Kohëzgjatja e punës:** 1 vit me mundësi vazhdimi
- **Paga bruto:** Në bazë të Rregullores për Paga.

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për punët organizative të burimeve njerëzore (BNJ), përgatitë procedurat për rekrutim të personelit gjatë vitit kalendarik në harmoni me kërkesat e menaxhmentit të TU.
- Përgatitë procesin e intervistimit të kandidatëve, listën e kandidatëve për intervista, listën për testim dhe listën e shpalljes për kandidat të përzgjedhur.
- Mbanë përgjegjësi për dosjet e punëtorëve si dhe mban ne konfidencialitet të plote dosjet e secilit të punësuar në TU.
- Pranon fletëparaqitjet disiplinore dhe i dërgon tek komisioni disiplinor, ndihmon komisionin disiplinor në përgatitjen e rasteve dhe nxjerrjen e provave, njëherit shërben edhe si sekretar teknik i komisionit.
- Përgatitë dhe procedon procedura, duke u bazuar në rregullat e brendshëm, ligjeve përgatitë procedurat për masë disiplinore për të gjithë punëtorët e TU që shkelin rregullat e punës sipas rregullave, procedurave dhe ligjeve që janë në fuqi.
- Përpunon të gjitha të dhënat statistikore që janë relevante me administrim të personelit në nivel të TU.
- Përgatitë programin e trajnimeve për stafin e TU, përgatitë plane, mujor dhe vjetor për burimet njerëzore.
- Punon në bazë të procedurave të administrimit të personelit, propozon hartimin e procedurave për administrimin e personelit,
- I përgatit kontratat e punës për të gjithë punëtorët e TU, i përgatit vendimet për pushim vjetor, i përgatit kartelat e identifikimit për punëtorët e TU, në bashkëpunim me Sekretarin e ndërmarrjes.
- Azhuron punët në dosjet e punëtorëve dhe punët në modulën e Burimeve Njerëzore, mbanë evidenca për pushimet e punëtorëve të përcaktuar sipas Ligjit të Punës në fuqi.
- Ndihmon në përgatitjen teknike të trajnimeve konform rregullores së brendshme të trajnimeve për stafin e TU.
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës si dhe detyrave të ngarkuara nga Sekretari.

### 1. Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në Juridik, Administratë Publike apo Shkenca Sociale;
- Përvojë pune në Burime Njerëzore së paku 1 vit të dëshmuar edhe përmes Trust-it.
- Njohuri të mira rreth Ligjit të Punës, identifikimin e nevojave për trajnime dhe organizimin e tyre, organizimi i stafit, identifikimi i nevojave të stafit që lidhen me natyrën e punës, përpilimi i shkresave dhe aftësi analitike etj..
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Aftësi të mira të teknologjisë, programet Microsoft Office (Word, Excel, Outlook).
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.

### 2. Dokumentacioni i kërkuar:

-Kandidati/ja, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com):

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së
- <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës.
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

### Informata të përgjithshme:

-- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

### Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)

Konkursi është i hapur nga data **17.09.2021** dhe përfundon më datë **01.10.2021** në ora 24:00

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

NPK "Trafiku Urban" SHA  
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë  
web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 45 10 11 33



**MILLENNIUM  
FOUNDATION  
KOSOVO**

## SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Independent evaluator for procurement of the information systems (design, supply, and installation) ICT systems for public access to judicial information
Procurement Ref. Number	IC/ MFK/2021/021
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Services (Individual Consultant)
Employer	Millennium Foundation Kosovo
Publication Date	16 September 2021
Submission Deadline	28 September 2021; 11:00 am (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The Millennium Foundation of Kosovo (MFK), the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for Independent Evaluator for the Procurement Activity - Independent evaluator for the information systems (design, supply, and installation) ICT systems for public access to judicial information.

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the Threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites Individual Consultant to provide the consultant services referenced above ("Proposals"). More details on these consultant services are provided in the Terms of Reference.

This Letter of Invitation (LOI) is open to all eligible entities ("Individual Consultant") who wish to respond. Subject to restrictions noted in the LOI.

A Consultant will be selected under the Individual Consultant Selection (IC), the evaluation procedure for which is described in sections of the LOI in accordance with "MCC Program Procurement Guidelines" which are provided on the MCC website ([www.mcc.gov/ppg](http://www.mcc.gov/ppg)). The selection process, as described, will include a review and verification of qualifications and past performance, including a reference check, prior to the contract award.

A complete set of LOI documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible consultants:

<https://millenniumkosovo.org/procurement/selection-of-an-individual-consultant-for-independent-evaluator-for-public-access-to-judicial-information-for-millennium-foundation-kosovo-ic-mfk-2021-021>

Consultants interested in submitting a proposal should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the LOI to the Procurement manager at [procurement@millenniumkosovo.org](mailto:procurement@millenniumkosovo.org), giving full contact details of the consultants.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in LOI rejection. The File link for submission of qualifications is included in the LOI document.

Applications shall be submitted ONLY to the file request link provided in LOI documents no later than **28 September 2021; 11:00 am (Kosovo Time)**. Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

<b>The address referred to above is:</b>	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
<b>Attn:</b>	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
<b>Tel:</b>	00 383 38 752 110
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:procurement@millenniumkosovo.org">procurement@millenniumkosovo.org</a>
<b>Website:</b>	<a href="http://www.millenniumkosovo.org">www.millenniumkosovo.org</a>



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook


[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 ☎ +386 49 848 553

PRISHTINË



☎ 044 900 978 | 045 681 898

📍 Salloni Depilimi Lume's Details

📷 lumesdetails

📍 Mbrapa Teatrit, 4 Qullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Kompania Ndërtimore ANBI SH.P.K. Njësia Në Kosovë me seli në Prishtinë, me numër të biznesit: 70534932 shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH - se me numër: 3010407 të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.

► Shpresa Azemi shpalle te pavlefshme deftesen e shkolles fillore " Fazli Greicevci "

► Florita Pergjegjaj shpall të pavlefshme dëftesën e kl. XII të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Ruzhdi Fila shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. "Mustafa Bakija" Yll Morina nga jl. 1-8 Gjakovë.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Valentina Hoxhaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. "Ali Hasi" Cermjan KK Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Drenusha Murati shpall të pavlefshme certifikatën e testit maturës SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë."

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► "Atika CCD" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330410895.

► Jehona Krasniqi Shpalle te pavlefshme deftesat diplomën dhe certifikatën e SHMLM " Dr Xheladin Deda"

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €. Tel: 044-185-233.

► Lendrit Gashi B.I Shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810113382

► Nebih Kadriu B.i shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 70698692

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Gjynejd Arifi shpalle te pavlefshme me diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani"

► Bajram Skenderi shpalle te pavlefshme deftesën e shkolles fillore "Skenderbeu"

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Avni Sadiku shpalle te pavlefshme deftesën e shkolles fillore "Xhevat Jusufi"

► Teuta Osmani shpalle te pavlefshme diplomën dhe deftesat e SHMLE " Hasan Prishtina "

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Adem Pllana "Auto Taxi" shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb:71090132

► Diellza Rexha shpalle te pavlefshme deftesën e klases se 6,7,8,9 te shkolles fillore "Abdullah Shabani"

► Lëshoj lokal në qira. Lokal është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokal gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Blerim Topanica shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani"

► Luljeta Murati shpalle te pavlefshme deftesat nga klasa 6-9 te shkolles fillore "Migjeni"

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Besim Asllani shpae te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani"

► Lavdim Sherifi shpalle te pavlefshme deftesën e shkolles Fillore "Bedri Gjinaj"

► Amir Azemi shpalle te pavlefshme deftesën e shkolles fillore "bislim Imeri"

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Ardial Durmishaj shpalle te pavlefshme deftesën e klases se 9-te te shkolles fillore "Ismail Qemali"

► Lirigzon Salihi shpalle te pavlefshme deftesat dhe diplomën e SHMLM " Dr xheladin Deda"

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Sherif Uka shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




## PASHTETË PULE

gluten  
free

MEKA  
HALAL FOOD



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues